



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

Tiranë, më 29.03.2022

RAPORT

(Komision për dhënie mendimi)

PËR

AKTIN NORMATIV

NR. 3, DATË 12.03.2022

“PËR

DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.115/2021,

“PËR BUXHETIN E VITIT 2022”

I. Hyrje

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 29.03.2022, mori në shqyrtim Aktin Normativ nr. 3, datë 12.03.2022, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputetin Z. Klevis Xhoxhi

Në mbledhjen e Komisionit për të mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të Komisionit ishin të pranishëm dhe Znj. Delina Ibrahimaj, Ministre e Financave, Znj. Moza Dhambi, Drejtoresh e Përgjithshme e Buxhetit dhe z. Ildir Gjata, Këshilltar i Kabinetit të ministres.

II. Baza ligjore Kushtetuese

Akti normativ nr.3, datë 12.3.2022 është paraqitur për miratim nga Këshilli i Ministrave dhe shqyrtohet nga Kuvendi mbështetur në bazën kushtetuese e ligjore, si më poshtë:

- nenet 101 dhe 160 të Kushtetutës;
- nenin 46 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
- rregullat e përcaktuara në kreun III të pjesës së dytë të Rregullores së Kuvendit.

Akti normativ shoqërohet me relacionin përkatës, sipas kërkesave të nenit 68 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë.

III. Qëllimi i projektligjit dhe përmbajtja e tij

Qëllimi i projektligjit:

Ky rishikim i buxhetit 2022, i cili propozohet me këtë akt normativ, ka si synim kryesor:

- Akordimin e mbështetjes buxhetore për sektorin e energjisë, prej 20 miliardë lekësh;
 - Financimin e një fondi kontigjencë për paketën e rezistencës sociale ndaj pasojave të krizës, prej 6 miliardë lekësh;
 - Reflektimin në kahun e të ardhurave me një rritje në masën 10 miliardë lekësh.
- Kjo rritje vjen e bazuar në performancën pozitive të realizimit të planit të të ardhurave tatimore dhe doganore nga administrata fiskale, për 2-mujorin e parë të vitit 2022.

Përmbajtja e projektligjit:

Akti Normativ nr. 3, datë 12.03.2022, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, referuar zërave më të rëndësishëm përcakton:

- Në kahun e të ardhurave:

Bazuar në realizimin e planit të të ardhurave për 2-mujorin 2022, është propozuar rritja e të ardhurave tatimore në masën 10 miliardë lekë, përkatësisht në këto zëra:

✓ Tatimi mbi vlerën e shtuar	+7 miliardë lekë
✓ Tatimi mbi fitimin	+ 2 miliardë lekë
✓ Akciza	+2 miliardë lekë
✓ Tatimi mbi të ardhurat personale	+2 miliardë lekë
✓ Taksa nacionale	- 3 miliardë lekë

Totali +10 miliardë lekë

- Tek shpenzimet korrente:
 - ✓ Parashikimin e një mbështetjeje financiare për sektorin energjetik në masën 20 miliardë lekë, e cila do të përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave.
 - ✓ Akordimin e një pakete gjithëpërfshirëse financiare të ashtuquajtur të rezistencës sociale ndaj pasojave të krizës në masën 6 miliardë lekë, e cila do të përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave për zbutjen e efekteve të krizës aktuale, në mbështetje të:
 - *Shtresave në nevojë*
 - *Sektorit të transportit publik*
 - *Sektorit të bujqësisë*
 - ✓ Reflektimin e shkurtimeve të zërave të shpenzimeve korrente për të gjitha institucionet buxhetore prej 5.8 miliardë lekë përmes aplikimit të një formule në masën:
 - *Reduktim -2.5% për shpenzimet e personelit*
 - *Reduktim -10% për shpenzimet operative në tërësi dhe -10% ekstra për shpenzimet e ngushta administrative.*
 - ✓ Etj;
- Tek shpenzime kapitale:
 - ✓ Për projektet me financim të brendshëm është reflektuar një shkurtim i përgjithshëm në masën rreth 5.2 miliardë lekë, përmes pakësimit të fondeve të:
 - *Projekteve të reja (të pa prokuruar ende)*
 - *Projekteve me sfond administrativ (pajisje zyrash, autovetura, etj)*
 - *Projekteve infrastrukturore, të cilëve u shtyhet koha e implementimit.*
 - *Etj .*
 - ✓ Për projektet me financim të huaj është reflektuar një shkurtim i përgjithshëm në masën 4.6 miliardë lekë, përmes pakësimit të fondeve të:
 - *Projekteve të reja infrastrukturore, me pritshmëri të ulët realizimi për 2022.*

Theksoj se, ndryshimet e propozuara nuk prekin deficitin buxhetor, i cili nuk ka pësuar ndryshime me këtë akt normativ.

IV. Vlerësimi i kushtetueshmërisë së aktit normativ

Neni 101 i Kushtetutës ka parashikuar të drejtën e Këshillit të Ministrave për të nxjerrë akte rregullatore me fuqinë e ligjit. Sipas këtij neni:

Neni 101

Këshilli i Ministrave, në rast nevoje dhe urgjence, nën përgjegjësinë e tij, mund të nxjerrë akte normative që kanë fuqinë e ligjit, për marrjen e masave të përkohshme. Këto akte normative i dërgohen menjëherë Kuvendit, i cili mbledhet brenda 5 ditëve nëse nuk është i mbledhur. Këto akte humbasin fuqinë që nga fillimi, në qoftë se nuk miratohen nga Kuvendi brenda 45 ditëve.

Komisionit për Çështjet Ligjore e vlerëson aktin normativ nga këndvështrimi i respektimit të parimeve kushtetuese. Konkretisht:

- a) nëse ekziston nevoja dhe urgjenca;
- b) masat janë me karakter të përkohshëm;
- c) Kuvendi miraton aktin brenda 45 ditëve nga data e nxjerrjes së tij.

Lidhur me çështjen e parë: nevoja dhe urgjenca.

Vlerësimi i nevojës dhe urgjencës bazohet në rrethanat konkrete dhe kriteret e analizuar nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

E drejta për të nxjerrë një akt me fuqinë e ligjit ka natyrë lejuese dhe përjashtimore, prandaj Kushtetuta e ka kushtëzuar ushtrimin e saj me ekzistencën e nevojës dhe urgjencës si rrethana dhe situata fakti që vlerësohen rast pas rasti, si dhe me kontrollin përfundimtar nga Kuvendi të akteve të nxjerra.

Sipas dispozitave kushtetuese, akti normativ me fuqinë e ligjit, në mungesë të kohës së nevojshme për të filluar një procedurë normale të miratimit të një propozimi për të ndryshuar ligjin, është një instrument që mundëson përshpejtimin e procedurave për nxjerrjen e ligjit.

E drejta për të ndryshuar buxhetin gjatë një viti parashikohet në Kushtetutë (neni 160) dhe në ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor.

Neni 101 ka parashikuar “nevojën” dhe “urgjencën” si rrethana dhe situata fakti që vlerësohen rast pas rasti. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, pas vlerësimit të ecurisë 2 mujore të treguesve makro-fiskale e buxhetore, ka ndërmarrë procesin dhe ka përgatitur skenarin e rishikimit të buxhetit 2022.

Ky rishikim i buxhetit 2022 propozohet t’i nënshtrohet procedurës së aktit normativ, aspekti i nevojës dhe urgjencës të së cilit lidhet me fokus primar akomodimin e financimit të nevojshëm për mbështetjen e sektorit energjetik, krahas mbështetjes për shtresat dhe sektorët e tjerë të impaktuar nga situata e krizës.

Lidhur me elementin e dytë: përkohshmërinë e masave që përmban akti normativ.

Akti normativ vepron me fuqinë e ligjit për një periudhë kohe, maksimalisht 45-ditore. Ai parashikon masa që do të zbatohen brenda vitit 2022.

Lidhur me elementin e tretë: fuqia ligjore e aktit normativ dhe miratimi nga Kuvendi i Shqipërisë brenda 45 ditëve.

Akti normativ është miratuar nga qeveria më 12.3.2022 dhe është paraqitur në parlament menjëherë.

Komisioni i ligjeve si komision për dhënie mendimi i shqyrton brenda afateve të parashikuara në rregulloren e Kuvendit.

Akti normativ nr. 3, gjithashtu, plotëson të gjitha kriteret e analizuara nga Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj, veçanërisht vendimet nr.24, datë 10.11.2006, nr.23, datë 16.4.2014 etj. Konkretisht, për miratimin e një akti normativ kërkohet të plotësohen kushtet që vijnë:

- a) Nevoja dhe urgjenca si kushte për nxjerrjen e aktit normativ me fuqinë e ligjit
- b) Përkohshmëria e masave që përmban akti normativ me fuqinë e ligjit
- c) Fuqia ligjore e këtyre akteve dhe kufizimet për nxjerrjen e tyre
- ç) Miratimi i aktit normativ me fuqinë e ligjit nga Kuvendi

V. Çështje të diskutuara në komision

Znj. Ibrahimaj, theksoi se rialokimet bazohen në një analizë që Ministria e Financave dhe e Ekonomisë ka kryer duke identifikuar nevojat më emergjente, të ardhura si pasojë e rritjes së çmimeve si pasojë e luftës në Ukrainë, të cilat adresohen në zgjidhjen e tyre mes propozimit të paraqitur mes aktit normativ.

Z. Klevis Xhoxhi, në cilësinë e relatorit theksoi se ndryshimet buxhetore, të parashikuara në aktin normativ, janë të domosdoshme në situatën ku ne ndodhemi. Këto ndryshime mundësojnë akordimin e mbështetjes buxhetore për sektorin e energjisë dhe financimin e një fondi kontigjencë për paketën e rezistencës sociale ndaj pasojave. Gjithashtu kemi reflektimin me rritje në krahun e të ardhurave tatimore dhe doganorte, si rrjedhojë e analizës 2 mujore të performancës së buxhetit 2022.

Gjatë diskutimit, Komisioni mbështeti qëndrimin e relatorit dhe e vlerësoi projektligjin shumë të rëndësishëm.

VI. Përfundim

Në përfundim të shqyrtimit të këtij projektligji, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi vlerësoi se:

Në aspektin ligjor, vlerësoj se projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në përfundim, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, **votoi projektligjin në parim, nen për**

nen dhe në tërësi dhe me shumicën e votave e miratoi atë dhe u shpreh dakord t'i përcillet Komisionit Përgjegjës për vijimin e procedurës sipas Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

RELATOR

Klevis XHOXHI

KRYETARE

Klotilda BUSHKA